



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 5.2.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljeviq Slavko Simiq, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Munguan: Agim Çeku, Mufera Sinik, Fisnik Ismaili, Rustem Berisha dhe Qerim Bajrami.

Në mbledhje morën pjesë edhe drejtori i OSBE-së Tuetsch Christopher, zyrtar i OSBE-së Welling Pehas, gazetar nga Horizont 21- Besart Hyseni, zyrtari i Shoqatës së Boshnjakëve të Kosovës dhe diasporës- Fatir Berati dhe përfaqësues për media i Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Iliaz.

Nga njësia për mbështetje të Komisionit, Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Zhivković, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i planit të punës së Komisionit, për vitin 2016.**
- 3. Të ndryshme**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Miratimi i planit të punës së Komisionit, për vitin 2016.**

Jasmina Zhivković, kryesuese – në bazë të Rregullores së Kuvendit dhe mbi bazën e programit Legjislativ të Qeverisë për vitin 2016, ngarkohet Komisioni të hartojë planin e punës për vitin 2016.

Plani i punës pasqyron aktivitetet e komisionit për vitin 2016, më këtë rast do të modifikohen propozimet dhe sugjerimet e anëtarëve të komisionit.

Gjatë punës, u shqyrtuan aktivitete të ndryshme që ndërlidhen me përgjegjësitë e Komisionit, siç janë: shqyrtimi i të gjitha projektligjeve me raportet e komisioneve funksionale nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga ana e Qeverisë. Këtë vit, si aktivitet i ri është procesi i mbikëqyrjes buxhetore të resorit të linjës përkatëse.

Detyrë kryesore e Komisionit është dërgimi i rekomandimit për Kryesinë, lidhur me raportin me rekomandime mbi monitorimin e zbatimit të Ligjit për Hoqë të Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, me qëllim të aprovimit në Kuvend.

Kompetencat kryesore të Komisionit janë mbikëqyrja e zbatimit të Ligjeve. Si prioritet nga viti i kaluar është vazhdimi i punës së monitorimit për zbatim të Ligjit për Shërbimin Civil, konkretisht neni 11.

Sa i përket procesit të monitorimi të Ligjeve, komisioni formon grupet punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal. Do të organizohen debate publike për shkallën e zbatimit të ligjeve të lartcekura. Në fazën e fundit, grupet punuese përgatisin draft- raportin me rekomandime dhe raportojnë në Komision ku të njëjtit do të procedohen për miratim në Kuvend.

Përgatitja e draft- raportit të grupit të punës dhe raportimi në Komision për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047, për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Më pas do të hartohet raporti final me rekomandime në cilësinë e Komisionit raportues, për miratim në Kuvend.

Një ndër aktivitetet kryesore të komisionit është kryerja e kontrollit të punës së Ministrisë përkatëse. Në këtë kontekst, komisioni do të ftojë për raportim ministrat e linjës përkatëse: Ministria për Komunitete dhe Kthim, Zyra për Çështje të Komuniteteve në Kabinetin e Kryeministrit, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Komisioni do të organizojë vizitë në MASHT, lidhur me pranimin e kandidatëve të komuniteteve jo shumicë në fakultete, në Universitetin “Hasan Prishtina” nga viti i kaluar akademik

Do të zhvillohen vizita pune në terren: KK Ferizaj, KK Gjakovë, KK Shtërpçë, KK Prizren - Mamushë, KK Albanik -Vraçevë-Breznicë-Kushtovë , KK Pejë -Gorazhdec, Brestovik, KK Skenderaj.

Komisioni planifikon realizimin e vizitave studimore në Republikën e Kroacisë në muajin maj 2016 dhe Mal të Zi në periudhën e dytë të vitit.

Në kuadër të propozimeve të anëtarëve, u mor qëndrim që komisioni të mbajë takime të rregullta çdo javë.

Për hartimin e Draft-Planit të Punës për vitin 2016, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi pikat si në vijim:

1. Shqyrtimi i të gjitha Projektligjeve në procedurë, në aspektin e të drejtave, interesave të komunitetit dhe kthim me raportet e Komisionit FunkSIONAL;
2. Në bazë të programit legjislativ të Qeverisë për vitin 2016, si komision FunkSIONAL shqyrton Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
3. Mbikëqyrja do të bazohet në Planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Integritet Evropian (çështje që dalin nga ligjet e që janë të lidhura me të drejta dhe interesat e komuniteteve dhe mbrojtjen e tyre). Komisioni, bën mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre ligjeve:
 - Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (veçanërisht neni 11);
 - Ligji për Vetëqeverisje lokale; dhe
 - Ligji për Financat e Pushtetit Lokal (mbikëqyrja e zbatimit të ligjit dhe mbikëqyrja buxhetore).
4. Raportimi periodik i ministrave, në trajtimin e çështjeve të caktuara nga fushëveprimtaria e komisionit;
5. Procesi i mbikëqyrjes buxhetore e shpenzimeve të ministrisë së resorit të linjës përkatëse. Organizimi i dëgjimit publik lidhur me raportin e ministrisë së linjës për shpenzimet buxhetore për tremujorin e parë dhe tremujorin e dytë të vitit 2016.
6. Vizita e Komisionit në terren lidhur me procesin e monitorimit të ligjeve;
7. Vizitë studimore e Komisionit në Republikën e Kroacisë dhe Malit të Zi ;
8. Identifikimi i objektivave nga Programi legjislativ i Qeverisë për vitin 2016;
9. Shqyrtimi dhe vlerësimi i Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017;
10. Komisioni përcakton një përfaqësues të vet për pjesëmarrje në shënimin e “ditëve festive për komunitete” , në vende të ndryshme të Republikës së Kosovës.

Në bazë të propozimeve në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 ,7, 8, 9 dhe 10, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë .

Përfundim

Komisioni miratoi Planin e Punës për vitin 2016, më datën 5.02.2016, me qëllim që të bëhet rishqyrtimi i planit dhe i rezultateve të punës për gjashtëmujorin e dytë dhe ndryshimi eventual i planit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Zhivkoviq